



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 91, Datë 28.04.2022

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË  
“KURUM INTERNATIONAL” SH.A., ME NR. 372, SERIA F12/17, NË  
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME  
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 106, DATË 20.07.2012, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “d”, nenit 5, pika 1, gërma “d”, nenit 10, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.04.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 579/2 prot, datë 20.04.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “KURUM INTERNATIONAL” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “KURUM INTERNATIONAL” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE nr. 404/1 prot., datë 05.04.2022, ka paraqitur kërkesën për të rinovuar licencën në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të Aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe

dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; Dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike.

Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim, Neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, **plotësuar.**
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, **plotësuar.**
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, Neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, **plotësuar.**
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë furnizimit të energjisë elektrike, Neni 9, pika 4.8 , gërmat “a”, “c”, “d”, “e”, “f”, **plotësuar.**

Në lidhje me dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 2:

- **gërma “d”** (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë),  
**Shoqëria duhet të përcjellë në ERE vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë së rrethit Tiranë për vetë shoqërinë, administratorin e saj dhe përfaqësuesin ligjor.**

Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, Neni 9 , pika 4.7

- **gërma “g”** (Dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’i ofrohen klientëve.) **Shoqëria nuk ka përcjellë dokumenta në lidhje me këtë kërkesë të rregullores dhe do t’i kërkohet t’i depozitojë në ERE.**
- **gërma “h”** (Të dhënat për klientët dhe energjinë e furnizuar). **Shoqëria nuk ka përcjellë dokumenta në lidhje me këtë kërkesë të rregullores dhe do t’i kërkohet t’i depozitojë të dhënat në ERE.**
- **gërma “i”** (Niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët.) **Shoqëria nuk ka përcjelle dokument në lidhje me këtë kërkesë të rregullores, do t’i kërkohet ta depozitojë në ERE.**
- Shoqëria në zbatim të nenti 7, pika 2, gërma “a”, të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjise elektrike*”, e ndryshuar, duhet të përcjellë në ERE prokurën ose autorizimin për përfaqësimin e saj në ERE, sipas deklarimit të bërë nga vetë ajo në Formatin e Aplikimit, do të njoftohet shoqëria që t’i përcjellë në ERE brenda afateve dokumentat në zbatim të rregullores.
- Shoqëria “KURUM INTERNATIONAL” sh.a. është mbajtëse e licencës nr. 372, Seria F12/17, në veprimtarinë së furnizimit të energjisë elektrike që nga data 20.07.2012, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 106, i ndryshuar me vendimin nr. 87, datë 07.06.2017, me afat vlefshmërie deri më datë 07.06.2022.

- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.
- Shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj më datë 05.04.2022, pra brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Shoqëria “KURUM INTERNATIONAL” sh.a. ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 372 Seria F12/17, të shoqërisë “KURUM INTERNATIONAL” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 20.07.2012, i ndryshuar për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 08.06.2022.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**